



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK Nr. Prot. 01-262/15
 Dep. 03 Br. Prot. 01-262/15
 Nr. i faq. 03 Prot. No. 01-262/15
 Broj stranica 03 Data 02-02-2015
 Nr. pages 03 Datum 02-02-2015
 PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	02.02.2015
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Abdulsatar IBRAHIMI Drejtore i Departamentit të Prokurimit në Kostt sh.a.
CC:	z. Naim BEJTULLAHU Kryeshef Ekzekutiv në Kostt sh.a.
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtore i Agjencisë Kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Furnizimi me inventar për zyret e reja "



I nderuari z. Ibrahim ,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me Tenderin "Furnizimi me inventar për zyret e reja" me numër prokurimi: 023/70-15-61/2014-121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " Furnizimi me inventar për zyret e reja " me numër prokurimi: 023/70-15-61/2014-121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

Arsyetimi

Për rastin me nr. protokoli: DPKPP 03-03-191/15

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut- Kostt sh.a. përmes Departamentit të Prokurimit ka iniciuar procedurën e prokurimit me titull " **Furnizimi me inventar për zyret e reja** " me numër prokurimi: 023/70-15-61/2014-121 e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.21.01.2015 në Procedurën e Hapur me vlerë të mesme të kontratës. Agjencia kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar dhe trajtuar dokumentacionin për këtë procedurë të prokurimit. Gjatë shqyrtimit dhe ekzaminimit të dokumenteve të dosjes së këtij tenderi, AKK ka hasur në disa kërkesa të vendosur në DT, të cilat janë në kundërshtim me Legjislacionin në fuqi i cili rregullon fushën e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit për këtë procedurë të prokurimit AKK ka konstatuar se në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit tek pika 9.1 Kërkesat mbi mundësitë teknike ose profesionale tek kërkesa **1. janë kërkuar dy kontrata ose referenca, ndërsa tek dëshmitë e kërkuara dokumentare: dëshmia 1. si dëshmi janë kërkuar së paku dy Kontrata apo Referenca nga viti 2011 me Institucionet publike, Bankat apo Misionet ndërkombëtare, për furnizim me Inventarë për zyra**, kërkesë kjo për të cilën Agjencia konsideron se është diskriminuese dhe kufizon konkurrencën e lirë në mesin e Operatorëve ekonomik. Sipas LPP-së Autoriteti kontraktues ka të drejtë të kërkojë kontrata dhe referenca për furnizimet që ka realizuar Operatori ekonomik me Institucionet Publike, misionet ndërkombëtare dhe Private, mirëpo nuk është e lejuar që të kërkojnë kontratat dhe referencat vetëm nga bankat si Institucione Private, por duhet të pranohen kontratat dhe referencat edhe nga Institucionet tjera Private, përveç Bankave. Gjithashtu nuk është e lejuar që kontratat apo referencat të kërkojnë nga viti 2011, por të njëjtat duhet të kërkojnë për vitet 2012,2013 dhe 2014.

Agjencia Kundër Korrupsionit gjithashtu vëren se kërkesa e vendosur në Dosjen e Tenderit tek Rubrika 9.1 Kërkesat mbi mundësitë teknike ose profesionale ku kërkojnë dy kontrata ose referenca është në kundërshtim me nenin 23 të Udhëzuesit Operativ. Autoritetit Kontraktues nuk i lejohet që ta pranojë vetëm njërin prej tyre. Në bazë të kësaj kërkesë të formuluar në këtë mënyrë Operatorët ekonomik mund të ofrojnë vetëm dy kontrata pa ofruar referenca në lidhje me përfundimin e kënaqshëm të furnizimeve e një dëshmi e tillë nuk do ta siguronte Autoritetin Kontraktues se Operatori ekonomik përkatës ka realizuar me sukses furnizimet pa kërkuar edhe referenca në lidhje me përfundimin e kënaqshëm të Kontratave.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi, nenin 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare, nenin 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 dhe me nenin 23 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet të lejohen dhe të përsëriten në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !